

URDHËR
Nr.183, datë 26.5.2011

PËR TARIFAT E SHËRBIMEVE QË KRYHEN NGA DREJTORITË E
ADMINISTRIMIT DHE MBROJTJES SË TOKËS NË QARK

Në mbështetje të nenit 102, pika 4 të Kushtetutës dhe pikës 5 të nenit 12 të ligjit nr.8752, datë 26.3.2001 “Për krijimin dhe funksionimin e strukturave për administrimin dhe mbrojtjen e tokës”, të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Tarifat e shërbimeve që do të kryhen nga drejtoritë e administrimit dhe të mbrojtjes së tokës (DAMT) në qark do të jenë:

- | | |
|--|------------|
| - Vërtetim pronësie para vitit 1946 | 1000 lekë; |
| - Vërtetim pronësie pas vitit 1946 | 1000 lekë; |
| - Vërtetim negativ para reformës, për në gjykatë | 500 lekë; |
| - Vërtetim pronësie për Agjencinë e Kthimit dhe Kompensimit të Pronave | 500 lekë; |
| - Vërtetim pronësie që kërkohet për statusin të pastrehë | 200 lekë; |
| - Konfirmim i vërtetimeve për ndihmë ekonomike e përkrahje sociale të ardhura nga komuna dhe/ose bashkia | 100 lekë; |
| - Harta e skica planimetrike-kadastrale | 1000 lekë; |
| - Vërtetime për kategorizimin e tokës, sipas bonitetit | 1000 lekë; |
| - Vërtetim me të dhëna nga formulari nr.6 | 500 lekë. |

2. Urdhri nr.482, datë 9.11.2004 “Për tarifat që kryhen nga seksionet e administrimit dhe mbrojtjes së tokës në qarqe”, i Ministrit të Bujqësisë dhe Ushqimit, shfuqizohet.

3. Ngarkohen drejtoritë e administrimit dhe mbrojtjes së tokës në qark për zbatimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I BUJQËSISË, USHQIMIT
DHE MBROJTJES SË KONSUMATORIT
Genc Ruli